



Npi – 01/169 datë 02.05.2025

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (d), nenin 14, nenin 17, shkronja (a dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Nenet 7, 14, 15, 16, 17, 19, 22 dhe 23 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092; Rregulloren e (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Vendimin paraprak të Kuvendit Npi – 01/384 Datë: 29.11.2024, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, Nr.333-16, Z.K-Davidoc. Si dhe në bazë të Rekomandimit, të Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale, Npi – 01/90 datë: 12.03.2025, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 02.05.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË FIRMËS “STN BETON” SH.P.K - DAVIDOC PRONËN E PALUAJTSHME KOMUNALE PREJ 2894 m² NË ZONËN KADASTRALE - DAVIDOC

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e jashtëzakonshme, të mbajtur më: 02.05.2025, me shumicën e votave miratoi vendimin që t'i japë në shfrytëzim afatgjatë për 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite, pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes Nr.P-72809023-00333-16, me sipërfaqe prej 2894m², në Zonën Kadastrale - Davidoc, me kompensim, firmës S.T.N. “BETON” SH.P.K. Numri i Biznesit: 810199712 me përfaqësues z.Shqipdon Abazi, adresa: Rruga “Ibrahim Rugova” Nr.1414 Davidoc, Nr. personal: 1175823219 Tel. mob. +383 (0) 44 509 222. E-mail: stn.beton@gmail.com .

II

Sipërfaqja e tokës që i është dhënë në shfrytëzim afatgjatë firmës STN “BETON” SH.P.K. gjindet në Rrugën “Ibrahim Rugova” Nr.1414 Davidoc. Ngastra Kadastrale Nr.P-72809023-00333-16 me sipërfaqe prej 2894 m², Zona Kadastrale-Davidoc, vendi i quajtur “Utrinë”, evidentuar në librat kadastral pronë e Komunës së Shtimes.

III

Pas përfundimit të afatit prej 99 viteve, nga data 02.05.2025, prona i kthehet titullarit të pronës – Kuvendit të Komunës së Shtimes.

IV

Sipërfaqja është e lejuar të shfrytëzohet vetëm për zhvillimin e biznesit që ka të bëjë me: Veprimtaritë shërbyese dhe përpunuese të lejuara me Çertifikatën e Biznesit Nr. 810199712. Në përputhje të plotë me legjislacionin dhe aktet tjera pozitive në Kosovë.

V

Autorizohet Ekzekutivi i Komunës që, duke u bazuar në këtë vendim dhe aktet pozitive në Kosovë, të kryej punët gjeodezike për rexhistrimin e pronës, të hartojë kontratën për shfrytëzimin e aseteve të Komunës me firmën STN "BETON" SH.P.K. të përcjellë implementimin e këtij vendimi që ka të bëjë me: Investime në shumën prej 190,121.50€ deri në vitin 2026. Të përcjellë punësimin e numrit e të punësuarve nga komuna e Shtimes prej 10 punëtorëve deri në fund të vitit 2026 të paraparë me planin e biznesit të firmës, të përcjellë veprimtarinë e firmës që është, shërbyese dhe përpunuese. Si dhe të përcjellë implementimin e tërësishëm të këtij vendimi.

VI

Kuvendi i Komunës së Shtimes, rezervon të drejtën që në rast të dështimit të biznesit të firmës STN "BETON" SH.P.K, ose në rast të mos fillimit të aktiviteteve punuese, brenda afatit prej 6 (gjashtë) muajve, të shkëputë kontratën njëanshëm dhe të anulojë këtë Vendim.

VII

E drejta e shfrytëzimit, nga firma STN "BETON" SH.P.K, nuk mund të shitet, trashëgohet, tjetërsohet ose bartet te personat e tretë, me ose pa kompenzim.

VIII

Kuvendi i Komunës, kërkon nga Kryetari i Komunës, si përfaqësues Ligjor, që në hartimin e Kontratës të përfshihen elementet e Planit të Biznesit të firmës, si dhe elementet e këtij Vendimi.

IX

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

X

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi